



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit
Sektori i Subjekteve Zgjedhore dhe Dekriminalizimit

Data	
Nr. Prot	

RELACION

PËR

SHPËRNDARJEN E MANDATEVE MIDIS SUBJEKTEVE ZGJEDHORE DHE
PËRCAKTIMIN E KANDIDATËVE FITUES NË ZONËN ZGJEDHORE QARKU
ELBASAN, PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “i”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miraton shpërndarjen e mandateve në zgjedhjet për Kuvendin, si dhe jep mandatet për çdo deputet.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objekti që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencë të Komisionerit për ta shqyrtuar.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.1328, datë 24.05.2025 , ka miratuar Tabelën Përmbledhëse të rezultatit për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputet për zonën zgjedhore Qarku Elbasan. Kundër këtij vendimi, brenda afateve ligjore u paraqitën kërkesa ankimore ku midis të tjerash u kundërshtua dhe vendimi nr. 1328, datë 24.05.2025. Në përfundim të shqyrtimit të ankimeve, Kolegji Zgjedhor vendosi rrëzimin e kërkesës ankimore dhe lënien në fuqi të vendimit të KAS nr. 100, datë 7.7.2025.

Me përfundimin e shqyrtimit të ankimeve, Komisioneri në mbështetje të nenit 162, pika 1, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, përllogarit shpërndarjen e mandateve për Kuvendin.

Në bazë të nenit 162, pika 1, përjashtohen nga shpërndarja e mandateve partitë politike ose koalicionet që kanë marrë më pak se 1(një) për qind të votave të vlefshme në shkallë vendi. Subjektet zgjedhore që plotësojnë kushtin për t’u përfshirë në përllogaritjen e shpërndarjes së mandateve janë:

Nr.	Subjekti zgjedhor	Vota	Përqindje
1	Koalicioni Partia Demokratike - Aleanca për Shqipërinë Madhështore	528592	32,91%
2	Lëvizja Bashkë	24547	1,53%
3	Partia Koalicioni Euroatlantik	20885	1,30%

4	Partia Socialiste e Shqipërisë	855831	53,29%
5	Koalicioni Nisma Shqipëria Bëhet	64212	4,00%
6	Partia Mundësia	48952	3,05%
7	Partia Socialdemokrate	49865	3,10%

Rezultati për Qarkun Elbasan për subjektet zgjedhore, sipas vendimit të KAS-it nr. 100, datë 7.7.2025, është si më poshtë:

Nr.	Subjekti zgjedhor	Vota	Përqindje
1	Koalicioni Partia Demokratike-Aleanca për Shqipërinë Madhështore	42.519	27,84%
2	Partia Lëvizja Bashkë	1.543	1,01%
3	Lëvizja Atdheu	173	0,11%
4	Partia Koalicioni Euroatlantik	2.436	1,60%
5	Partia Socialiste e Shqipërisë	93.765	61,41%
6	Koalicioni Nisma Shqiperia Bëhet	6.302	4,13%
7	Partia Aleanca Kombëtare Shqiptare	359	0,24%
8	Partia Aleanca Demokracia e Re	60	0,04%
9	Koalicioni Djathtas për Zhvillim	417	0,27%
10	Partia Mundësia	3.267	2,14%
11	Partia Socialdemokrate	1.858	1,22%
Totali i votave të vlefshme		152.699	100,00%

Subjektet zgjedhore që plotësojnë kushtin për t’u përfshirë në përlllogaritjen e shpërndarjes së mandateve kanë fituar vota si më poshtë:

Nr.	Subjekti zgjedhor	Vota	Përqindje
1	Koalicioni Partia Demokratike-Aleanca për Shqipërinë Madhështore	42.519	27,84%
2	Partia Lëvizja Bashkë	1.543	1,01%
3	Partia Koalicioni Euroatlantik	2.436	1,60%
4	Partia Socialiste e Shqipërisë	93.765	61,41%
5	Koalicioni Nisma Shqiperia Bëhet	6.302	4,13%
6	Partia Mundësia	3.267	2,14%
7	Partia Socialdemokrate	1.858	1,22%

Në bazë të nenit 162, pika 2, numri i votave të vlefshme në nivel zone zgjedhore të secilit subjekt pjesëtohet në mënyrë të vazhdueshme me numra natyrorë të njëpasnjëshëm, të quajtur pjesëtues, duke filluar me numrin 1 dhe duke përfunduar me numrin natyror që i korrespondon numrit të mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore Qarku Elbasan, që në bazë të vendimit nr. 14, datë 7.12.2024, të Komisionit Rregullator është është 14 (katërmëdhjetë).

Subjekti/pjesëtuesit	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	Herësit
PS	93765	46883	31255	23441	18753	15628	13395	11721	10418	9377	
PD-ASHM	42519	21260	14173	10630	8504	7087	6074	5315	4724	4252	
NISMA-SHB	6302	3151	2101	1576	1260	1050	900	788	700	630	
Mundesia	3267	1634	1089	817	653	545	467	408	363	327	
KEA	2436	1218	812	609	487	406	348	305	271	244	
PSD	1858	929	619	465	372	310	265	232	206	186	
BASHKE	1543	772	514	386	309	257	220	193	171	154	

Sipas nenit 162, pika 4, herësit e përftuar nga çdo pjesëtim, renditen nga herësi më i madh tek ai më i vogël, duke renditur përkrah tyre subjektin, të cilit i përket herësi përkatës. Renditja vazhdon derisa të renditen aq herës sa është numri i mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore Qarku Elbasan, që që në këtë rast është 14 (katërmëdhjetë). Nga kjo renditje marrim rezultatin si më poshtë:

Nr.	Subjekti zgjedhor	Herësit
1	PS	93765
2	PS	46883
3	PD-AMSH	42519
4	PS	31255
5	PS	23441
6	PD-AMSH	21260
7	PS	18753
8	PS	15628
9	PD-AMSH	14173
10	PS	13395
11	PS	11721
12	PD-AMSH	10630
13	PS	10418
14	PS	9377

Në bazë të nenit 162, pika 5, një subjekt zgjedhor përfiton një numër mandatesh të barabartë me numrin e herësve të përfshirë në listën e përcaktuar më sipër.

Sipas nenit 163, pika 1, të Kodit Zgjedhor, menjëherë pas përfundimit të llogaritjes së rezultatit si më sipër, KQZ-ja përllogarit shpërndarjen e mandateve për kandidatët fitues për secilin subjekt.

Sipas nenit 163, pika 3, të Kodit Zgjedhor mandatet për kandidatët fitues fillimisht shpërndahen sipas renditjes së listës shumemërore me renditje të fiksuar të subjektit zgjedhor dhe në përputhje me renditjen e kandidatëve në të.

Lista shumemërore me renditje të fiksuar të subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë për zonën zgjedhore Qarku Elbasan, sipas vendimit nr. 1328, datë 24.5.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve është si më poshtë:

Nr.	Kandidatët e subjektit Partia Socialiste			Gjinia
	Emër	Atësi	Mbiemër	
1	Arbjan	Cvetko	Mazniku	M
2	Bora	Kastriot	Muzhaqi	F
3	Ermal	Fetah	Elezi	M
4	Adi	Luan	Qose	M
5	Evis	Kolë	Kushi	F

Në rast shterimi të kësaj liste, vijohet me kandidatët fitues të rirenditur të listës shumemërore që i nënshtrohen votimit parapëlqyes në bazë të numrit më të lartë të votave parapëlqyese për secilin

kandidat, duke marrë për bazë dhe kriterin gjinor që një në çdo tre emra t'i përkasë gjinisë më pak të përfaqësuar.

Rezultati për kandidatët për deputetë të listës shumemërore për subjektin zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, për zonën zgjedhore Qarku Elbasan, sipas vendimit të KAS-it nr. 100, datë 7.7.2025, që i nënshtrohen votimit parapëlqyes e rirenditur duke përfshirë dhe kriterin gjinor, është si më poshtë:

Nr.	Kandidatët e subjektit Partiai Socialiste				
	Emër	Atësi	Mbiemër	Gjinia	Vota parapëlqyese
1	Sara	Përparim	Mila	F	20225
2	Saimir	Shpend	Hasalla	M	11272
3	Olsi	Lyto	Komici	M	10640
4	Aulona	Lavdim	Bylykbashi	F	10517
5	Agron	Fadil	Gaxho	M	6620
6	Shkëlqim	Shefqet	Bullari	M	5607
7	Geldon	Nias	Fejzo	M	5039
8	Luan	Xhemal	Duzha	M	3910
9	Dasantila	Mensur	Tahiraj	F	3557
10	Florenc	Fatmir	Spaho	M	3163
11	Ervina	Sefedin	Meta	F	2828
12	Ela	Enver	Toçka	F	1475
13	Musa	Ryzhdi	Coha	M	618
14	Arlind	Bajram	Kullolli	M	557
Gjithsej					86028

Për subjektin zgjedhor Partiai Socialiste e Shqipërisë, numri i mandateve të fituara është 10, çka përbën një tejkalim të numrit të kandidatëve në listën shumemërore me renditje të fiksuar. Për rrjedhojë, për 5 mandate të mbetura, vijon shpërndarja duke u mbështetur në kandidatët e rirenditur të listës shumemërore që i janë nënshtruar votimit parapëlqyes.

Pesë (5) kandidatët e parë të listës shumemërore që i nënshtrohen votimit parapëlqyes të rirenditur duke përfshirë dhe kriterin gjinor janë si më poshtë:

Nr.	Kandidatët e subjektit Partiai Socialiste			Gjinia	Vota parapëlqyese
	Emër	Atësi	Mbiemër		
1	Sara	Përparim	Mila	F	20225
2	Saimir	Shpend	Hasalla	M	11272
3	Olsi	Lyto	Komici	M	10640
4	Aulona	Lavdim	Bylykbashi	F	10517
5	Agron	Fadil	Gaxho	M	6620

Lista shumemërore me renditje të fiksuar të subjektit zgjedhor Koalicioni Partia Demokratike-Aleanca për Shqipërinë Madhështore sipas vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve 1328, datë 24.5.2025, është si më poshtë:

Nr.	Kandidatët e subjektit PD-ASHM			
	Emër	Atësi	Mbiemër	Gjinia
1	Tomor	Fejzi	Alizoti	M
2	Edmond	Llazar	Haxhinasto	M
3	Klodiana	Illir	Çapja	F
4	Blendi	Ferdinand	Himçi	M
5	Aurel	Nedai	Bylykbashi	M

Për subjektin zgjedhor PD-ASHM, numri i mandateve të fituara është 4 (katër), numër ky më i vogël se numri i kandidatëve në listën shumemërore me renditje të fiksuar. Në këto rrethana, katër kandidatët e renditur të parët, në përputhje me numrin e mandateve të fituara, shpallen fitues për zonën zgjedhore Qarku Elbasan. Për rrjedhojë, nuk është e nevojshme të shqyrtohet lista shumemërore që i nënshtrohet votimit parapëlqyes.

Për sa më lart në këtë relacion, në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i propozohet për shqyrtim dhe miratim, brenda kompetencave të veta, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve projektvendim “Për shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore dhe përcaktimin e kandidatëve fitues në zonën zgjedhore qarku Elbasan, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025”.

Licela Veliu - Drejtorja e Subjekteve Zgjedhore Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit

Pavlina Doçaj – Drejtorja e Ligjshmërisë

Daniela Alimemeti – Drejtorja e Logjistikës dhe Digjitalizimit

Aurel Lamçe – Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më

protdate

Nr.

protnumber

Data: DD MM VVVV

Nr:000-000

Ora: HH:MM

VENDIM

PËR

SHPËRNDARJEN E MANDATEVE MIDIS SUBJEKTEVE ZGJEDHORE NË ZONËN
ZGJEDHORE QARKU ELBASAN, PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ
2025

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, nenin 162 dhe nenin 163, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S:

1. Shpërndarjen e mandateve për subjektet zgjedhore në zonën zgjedhore Qarku Elbasan, si më poshtë:
 1. Partia Socialiste e Shqipërisë 10 mandate
 2. Koalicioni Partia Demokratike-Aleanca për Shqipërinë Madhështore 4 mandate
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASH

Data: dd mmvvvv Nr: _____
Ora: hh:mm



“Për shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore në zonën zgjedhore Qarku Elbasan për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”